



BASHKIA ROSKOVEC

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

OBJEKTI: BLERJA CAKELL PËR RRUGËT

SPECIFIKIME TEKNIKE

**SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR OBJEKTIN: “BLERJE ÇAKELL PËR RRUGËT” SIPAS PREVENTIVIT
BASHKËLIDHUR**

Bashkia Roskovec për nevojat e saj, për mirëmbajtjen e rrugëve të fshatrave dhe të parcelave në të gjithë territorin e saj kryen blerjen dhe transportin e çakëllit sipas.

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Cakell	M3	2000
2	Stabilizant	M3	2000
3	Rere Bituminoze	M3	400
	Shuma		
	TVSH20%		
	TOTALI		

Preventivi i hartuar nga inxhinieret e Bashkisë Roskovec ka parashikuar blerje materiali për zërat e mësipërm të cilët duhet të transportohen në rrugët që kanë nevojë planvendosje bashkëlidhur në të gjithë territorin e Bashkisë.

Këto materiale do të shpërndahen sipas nevojave të bashkisë gjithashtu duhet të merret parasysh distanca e rrugëve.

Çakëlli mbeturina (ose zhavorri) apo stabilizanti duhet të plotësojë këto kushte:

- Indeksi i plasticitetit nuk duhet të kalojë 10
- Nuk duhet të përmbajë grimca me përmasa mbi 2/3 e trashësisë së shtresës, në sasi mbi 5%.
- Nuk duhet të përmbajë mbi 10% grimca të dobëta dhe argjilore

Shpërndarja

Materiali do të shpërndahet përgjatë trasesë së rrugës në mënyrë të tillë që të plotësojë të gjitha kërkesat për trashësinë e shtresës, nivelet, seksionin tërthor dhe densitetin. Asnjë kurriz nuk duhet të formohet kur shtresa të jetë mbaruar përfundimisht.

Operatori fitues do të transportojë rërën bituminoze atje ku ka nevoj bashkia brenda territorit të saj.

Rëra bituminoze duhet të jetë e pastër nga trupat e huaj, gure, inerte, argjile, rërë etj.

Rëra bituminoze duhet të jetë e shkrifët dhe pa kokrriza.

Rëra bituminoze duhet te ketë:

Densiteti 1.8gr/cm³

Poroziteti (% peshë) 16.3

Përçindja e ujit 4.6%

Përçindja e bitumit 6-8%

Karakteristikat e Bitumit:

Pika e zbutjes 25-40 °C

Vajra (% në peshë) 40

Rëshira (% në peshë) 25

Asfaltene (% në peshë) 27

Squfuri 6-7.5%

Shkarkimi i rërës bituminoze nuk do te kryhet në një vend por gjatë gjithë gjatësisë së rrugës sipas kërkesës së bashkisë. Sasia e transportit ditor do të jete sipas kërkesës së bashkisë.

Operatori fitues ka për detyrë blerjen, transportin dhe shpërndarjen atje ku ka nevoj bashkia.

Rëra bituminoze duhet të merret direkt nga gërmimi në karrier dhe jo te jetë e depozituar ne karrieren e operatorit.

Përçindja e bitumin duhet të jetë 10-12% dhe të jetë e lidhur me rërën në mënyrë uniforme.

Pesha specifike e rërës pas përpunimit dhe pastrimit të saj ne objekt duhet të sillet me 1300-1850kg/m³.

Rëra duhet të sigurohet në një ndër kantierët e certifikuar për nxjerren dhe përpunimin e saj.

Grafiku i punimeve do të jetë 4 javë nga dita e lidhjes së kontratës.

Komisioni

Eneida HOXHA

Ermir Hajdini

Agron Dardha